



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



KOMUNA E PEJËS

Njesia e Prokurimit

Peje, datë, 04.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Pejes, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.07.2025 me titull LOT 4-Rekonstruimi i trotuarit në lagjen Fidanishte pranë rruges kryesore Nr. të Prok: 635-25-108-5-1-1 dhe nr i brendeshen 635-25-003-511 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet – kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik “Grup i Operatorëve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM ” të datës 31.07.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi dhe ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet -Lot 4 Rrekonstruimi i trotuarit në lagjen Fidanishte pranë rrugës kryesore” Nr. të Prok: 635-25-108-5-1-1 dhe nr i brendshëm 635-25-003-511 kundër B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK, të publikuar në platformën elektronike të E-Prokurimit .

Vërtetohet vendimi i A.K mbi B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK **ANULIM** të publikuar me datë: 30.07.2025 i drejte dhe mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “Grup i Operatorëve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM” me datën 31.07.2025, ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: “Asfaltimi dhe ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet”- Lot 4 Rrekonstruimi i trotuarit në lagjen Fidanishte pranë rrugës kryesore” Nr. të Prok: 635-25-108-5-1-1 dhe nr i brendshëm 635-25-003-511.

Pretendimet e OE

Lidhur me arsyen e parë të eliminimit AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve dhe në kundërshtim me Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë neni 1 citojmë:

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë

është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda

një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Sipas nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), në rast se operatori ekonomik nuk ka

paraqitur dokumentacion të plotë, Autoriteti Kontraktues ka detyrimin të kërkojë sqarime

apo plotësime para se të marrë vendim për eliminim. Në këtë rast, nuk është përmbushur

detyrimi ligjor i AK për kërkuar nga sqarime se a i posedojnë apo jo stafi i prezantuar certifikatat e kërkuara për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe eliminimi është bërë në mënyrë të padrejtë sepse të dy keta inxhinierë e posedojnë certifikatën për siguri dhe shëndet në punë.

PROVË : Certifikatë për pjesëmarrje në trajnim të datës 24.02.2025 për ing.arkitekturës & Certifikatë për pjesëmarrje në trajnim të datës 24.02.2025 për ing.gjeodezisë

PRETENDIMI NR.2

Lidhur me arsyen e dytë të eliminimit nga AK ku pretendon se "nuk është dëshmuar përvoja e kërkuar në realizimin e kontratave të ngjashme, sic kërkohet në në dokumentacionin e tenderit", ky konstatim është i gabuar.

Ne kemi paraqitur listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, e cila përmban të

gjitha të dhënat e kërkuara nga Aneksi 6 i Dosjes së Tenderit: titullin e kontratës, shumën,

datën e përfundimit, përfituesin dhe referenca për kryerjen e punëve. Kjo dëshmi është e

plotë dhe në përputhje me kërkesat e dokumentacionit të tenderit.

AK ka vepruar në kundërshtim me nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi)

dhe në kundërshtim me Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve. Eliminimi vetëm për mungesë të Aneksit 6, pa marrë parasysh dokumentacionin që kemi dorëzuar, është në kundërshtim me parimet e

proporcionalitetit

dhe barazisë, si dhe me trajtimin e drejtë të operatorëve ekonomikë

Poashtu AK në kundërshtim me LPP neni 59 Pika 4 citojmë:

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderinëfjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e

kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues

mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose

paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Duke marrë për bazë se ne kemi ofruar listën e kontratave të realizuara të vulosur dhe nënshkruar dhe me të gjitha elementet që kërkohen përmes aneksit 6, dhe me kontrata të realizuara në vlerë shumë më të madhe se ajo që është kërkuar, AK është dashur të marrë

përbaze këtë listë si dhe referencat (procesverbalet) e bashkangjitura ku shihet se është në

përputhje të plotë me nenin 59 pika 4 (II) dhe nuk përbëjnë asnjë ndryshim material ose

devijim nga karakteristikat kushtet ose kërkesat e DT.

PROVË: Lidhja e ofertës e krijuar nga platforma e-prokurimi ku shihen

dokumentet e ngarkuara nga ne të cilat e përmbushën dhe tejkalojnë kërkesën e AK (Fajlli Nr.4,5,6 dhe 7)

PRETENDIMI NR.3

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 105 - Kompetencat e OSHP

pika 2.7 & 2.8 citojmë:

2.7. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues, deri më tani të lejuar nga ky ligj, duke e detyruar autoritetin e tillë që të suspendojë ose përfundoj zbatimin e aktivitetit të prokurimit ose zbatimin e vendimit të autoritetit të tillë lidhur me ose gjatë aktivitetit në

fjalë;

2.8. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues, deri më tani të lejuar nga ky ligj, duke e detyruar autoritetin e tillë që të anuloj ose revokoj vendimin e autoritetit të tillë lidhur me

- ose të marrë gjatë aktivitetit të prokurimit, përfshirë kushtet e paligjshme dhe specifikat

në dosjen e tenderit;

AK ku nuk ka zbatuar vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik nr. 2025/0311, i

cili e obligon AK-në të bëjë rivlerësimin e ofertave. Në vend të kësaj, është marrë vendim

i njëanshëm për eliminim dhe anulim të aktivitetit, duke cenuar të drejtën tonë për një proces të drejtë dhe transparent.

PROVË: Vendimi i OSHP nr.2025/0311

PRETENDIMI NR.4

Meqenëse jemi OE i përgjegjshëm me cmimin më të ulët të ofruar AK nuk ka vepruar konform LPP neni 1 Qëllimi pika 1 citojmë :

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen

dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose

kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Poashtu jo konform LPP Neni 6 Ekomiciteti dhe Efikasiteti citojmë:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike

dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në

konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Pergjigja nga AK

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës, më datë 04.08.2025, ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM më datë 31.05.2025 dhe, pas analizës së bërë, ju njofton se ankesa në fjalë refuzohet si e pabazuar për arsyet si më poshtë:

Në dosjen e tenderit janë përcaktuar qartë kriteret e pranueshmërisë së operatorëve ekonomikë, kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale, kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, si dhe kërkesat mbi kapacitetet teknike dhe/ose profesionale.

Komisioni profesional i përbërë nga tre (3) anëtarë ka shqyrtuar me përpikëri dokumentacionin dhe ofertat e paraqitura, duke bërë vlerësimin në përputhje me

Ligjin për Prokurimin Publik dhe dokumentet e tenderit. Gjatë vlerësimit është konstatuar se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM nuk është në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Bazuar në nenin 59, pika 4 të Ligjit për Prokurimin Publik, një tender konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Sqarimet e kërkuara nga operatorët ekonomikë lejohen vetëm në rastet kur bëhet fjalë për gabime ose paqartësi që mund të korrigjohen pa ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës.

Në rastin konkret, operatori ekonomik nuk ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në dosjen e tenderit, duke krijuar kështu një mospërputhje thelbësore, e cila përbën shkelje materiale. Për pasojë, kjo mospërputhje nuk mund të korrigjohet pas afatit të dorëzimit të ofertave, përjashtimisht kur bëhet fjalë për dokumente që lidhen me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, në përputhje me ligjin.


Gjithashtu, theksojmë se të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit kanë vazhduar vlefshmërinë dhe sigurimin e ofertës, përveç operatorëve ekonomikë "BK - CONSTRUCTION SH.P.K." dhe "MONDI Sh.P.K.", të cilët nuk i kanë përmbushur këto kërkesa.

Duke u mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi dhe parimet e barazisë, konkurrencës dhe transparencës, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës, vlerëson se refuzimi i ofertës së operatorit ekonomik "Quality Asphalt" është bërë në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me legjislacionin përkatës.

Si rrjedhojë, ankesa e paraqitur **refuzohet si e pabazuar**.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane me lartë ka vendosur si në dispozitiv Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP- se duhet të dorëzohet brenda afatit ligjor .

Merespekt,
MILOT GASHI
Menaxher i Prokurimit



Vendimi i dorëzohet:

1. Një (1) kopje ngarkohet për mes platformës elektronike
2. Një (1) kopje – Arhivës A.K Komuna e Pejës.